



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

**Kryetarja e Komunës**

**01nr \_\_\_\_\_ 2015**

**Dt: 06.03.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11,13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve komunale, pas miratimit nga ana e drejtorëve të administratës komunale të kërkesës së DPPA-së, e cila është përcjellur dhe konfirmuar në formë elektronike, për dhënien e pëlqimit për subvencionimin e aktiviteteve të Organizatës së Pensionistëve në Gjakovë, me dt: 06.03.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

**I.** Miratohet kërkesa e Organizatës së Pensionistëve të Komunës së Gjakovës, e evidentuar me nr. 01-400-6040 e dt: 22.01.2015, për ndihmën e kësaj Organizate me subvencione komunale për realizimin e aktiviteteve të vitit 2015, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione në vlerë prej 2,630.00€ , sipas planit të shpenzimeve të bashkangjitur në kërkesë .

**II.** Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 2,630.00€, nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetares së Komunës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e Organizatës Komunale të Pensionistëve në Gjakovë nr. 1402000001751173 Banka Ekonomike.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

**IV.** Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative
- Z. Ibrahim Rudi, kryetar i Organizatës Komunale të Pensionistëve, Gjakovë
- Arkivit

**Kryetarja e Komunës,**  

---

**Znj. Mimoza Kusari- Lila**